




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "STILIANO BANDILLI"
BERAT

Nr. 231 prot.

Berat më 30 . 09 .2025

Lënda: Njoftim për vend i lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Urdhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional", i ndryshuar

Shkolla e mesme profesionale "Stiliano Bandilli", ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës për pozicionin "Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikës profesionale", drejtimi "Shërbime Mjetesh Transporti" (me kohë të pjesshme).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Alikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvleshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së (drejtimi SHMT)
- të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
- aftësi të tjera nëse kërkohen

2. Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin
- b) jetëshkrimin(CV)
- c) kartën e identitetit
- d) diplomën
- e) librezën e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 09.10.2025

3. vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e Njesisë së zhvillit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Drejtore i shkollës

Ing. Kozeta Nushi

